



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1355/prot.
4

Tiranë më 22.12.2017

VENDIM

Nr. 101, datë 22.12.2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Pay and Go" Shpk.

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 260, datë 12.10.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Pay and Go" Shpk mbajtës i nr. NUIS (L51418025N) me objekt:

- Zbatimi i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua se:

1. Kontrolluesi "Pay and Go" Shpk ushtron aktivitet tregtar për ofrimin e shërbimeve të pagesave për publikun nëpërmjet automateve për llogari të ofruesve të shërbimeve, përfshirë energjinë elektrike dhe ujin, si dhe faturat për telefoninë celulare, gjobat e policisë, mbushjen e llogarive të basteve online, shitjen e paketave telefonike tek klientët e shoqërive të telefonisë celulare, marketingun dhe tregtimin e pajisjeve elektronike, etj.

2. Nga verifikimi i kryer rezultoi se pasi klienti përfiton shërbimin, terminali e regjistron këtë transaksion të kryer me gjithë elementët përkatës të tij. Transaksioni i pagesës përmban detajet e pagesës së kryer nga klienti si emri i shërbimit, vlera, koha e kryerjes së transaksionit, statusi i tij. Në serverat qendrorë të kontrolluesit "Pay and Go" Shpk ruhen të dhënat (log) për të identifikuar në mënyrë të qartë këtë transaksion. Sistemi mundëson ruajtjen e të dhënave log të cilat nevojiten në rast investigimi të mëtejshëm për një transaksion. Ofruesit e

shërbimeve të ndryshme lidhen me serverat e kontrolluesit duke përdorur lidhjen *site to site* VPN ose lidhjen nëpërmjet internetit.

3. Gjatë shërbimit të ofruar kontrolluesi përpunon të dhëna personale si: numër celulari klienti (për kompanitë celulare), numër targe automjeti, numër kontrate (UKT, OSHEE, Digicom), numër personal karte identiteti (për veprime bankare) etj.

4. Nga verifikimi i kryer rezultoi se kontrolluesi ka kryer marketing të drejtpërdrejtë ndaj subjekteve të të dhënave duke përdorur database të pa autorizuar (klientë të operatorëve të telefonisë celulare) nëpërmjet numrit 044525050 në përdorim të tij. Kontrolluesi ka dërguar sms marketingu drejt subjekteve të të dhënave të dhënat e të cilëve janë mbledhur për qëllim tjetër (pagesa për faturat për telefoninë celulare) dhe nuk arriti të provojë marrjen e pëlqimit për të kontaktuar subjektet e të dhënave për qëllim marketingu, duke vepruar në kundërshtim me nenin 6 pika 1/a e Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

5. Kontrolluesi me qëllim suportin teknik dhe zhvillimin e sistemit ku mbështetet veprimtaria e tij, ka nënshkruar një kontratë mbi ofrimin e shërbimeve teknike me shoqërinë “MPS” LLC, me seli në Federatën Ruse. Në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë kontratë, shoqërisë “MPS” LLC i mundësohet akses *remote* në bazën e të dhënave në serverat qendrorë të “Pay and Go” Shpk, për të realizuar shërbimin teknik të kërkuar nga ky kontrollues.

Ky akses që i mundësohet shoqërisë së sipërpërmendur përbën transferim ndërkombëtar në kuptim të Ligjit 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Për këtë transferim të dhënash u konstatua se nuk është përmbushur detyrimi për të kërkuar autorizimin e Komisionerit për transferimin e të dhënave në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, siç konsiderohet Federata Ruse (Vendim i Komisionerit Nr. 8, dt. 31.10.2016 “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”), duke vepruar në kundërshtim me nenin 9 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

6. Kontrolluesi nuk i informon subjektet e të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë sipas neneve 12, 13, 15, 16 dhe 17 të ligjit, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë. Nga verifikimi i kryer në faqen online të kontrolluesit (payandgo.al), por edhe në терминаlet ku kryhet transaksioni, rezultoi të mos jenë publikuar “Politikat e privatësisë” të kontrolluesit, duke mos u dhënë mundësi subjekteve të të dhënave të informohen mbi mundësinë e ushtrimit të të drejtave të tyre, në kundërshtim me nenin 18 të

ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

7. Kontrolluesi ka vendosur në ambientet e brendshme kamera vëzhgim regjistrimi CCTV. Nëpërmjet sistemit të video-surveimit mbledh dhe përpunon të dhënat personale imazhe dhe video të subjekteve të të dhënave punonjës dhe klientë. Kontrolluesi ka në administrim 2 kamera të cilat janë të vendosura brenda ambientit ku ushtron aktivitetin. Këto të dhëna ruhen për një afat 20 ditor me qëllim garantimin e sigurisë dhe aksesohen vetëm nga administratori i shoqërisë. Kontrolluesi nuk kishte realizuar informimin e subjekteve të të dhënave nëpërmjet tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të kamerave të survejimit në hyrje të ambienteve, ku ushtron veprimtarinë e tij, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe me Udhëzimin e Komisionerit nr. 3, datë 05/03/2010 “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar.

8. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit si edhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se kontrolluesi nuk kishte përmbushur detyrimin për njoftim në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Kontrolluesi e përmbushi këtë detyrim, duke depozituar njoftimin sipas ligjit vetëm pasi u njoh me Urdhrin e Komisionerit për kryerjen e hetimit administrativ pranë tij.

9. Kontrolluesi ka hartuar “Rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale” por në përmbajtje të saj konstatohen mangësi sa i përket parashikimit të dispozitave lidhur me proceset e përpunimit. Rregullorja nuk është gjithëpërfshirëse duke mos parashikuar çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektësh të të dhënave sipas parashikimeve në nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

10. “Pay and Go” Shpk, në kuadër të ofrimit të shërbimit të pagesave për shoqëri dhe institucione të tjera, sipas marrëveshjes midis palëve, konsiderohet “përpunues” pasi i përpunon të dhënat personale të qytetarëve në emër dhe për llogari të këtyre shoqërive-institucioneve (në cilësinë e kontrolluesit). Në këtë kuadër, në raport me nenin 20 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, konstatohet se:

- Të dhënat personale të qytetarëve transferohen pa dijeninë e kontrolluesve, në kundërshtim me pikën 1/a të këtij neni;
- Nuk janë marrë masa lidhur me garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, në kundërshtim me pikën 1/c të këtij neni;

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin (datë 10/11/2017), si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në datën 23/11/2017, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit, është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesin e kontrolluesit, lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ.

Përfaqësuesi i kontrolluesit gjatë seancës dëgjimore parashtroi këto pretendime lidhur me konstatimet e grupit të inspektimit:

"Të dhënat e vendosura në dispozicion nga ofruesit e ndryshëm të shërbimeve nuk mund të konsiderohen si të dhëna personale pasi ofruesit e shërbimit ia vendosin në dispozicion informacionin Pay and Go Shpk në mënyrë të anonimizuar, këto të dhëna plotësojnë të gjitha kushtet që të konsiderohen të dhëna anonime. Dërgimi i sms të marketingut ka zgjatur për një periudhë dy ditore për shkak të përdorimit të një baze të dhënash të paautorizuar. Pay and Go Shpk nuk ka akses në të dhënat personale të individëve pasi këta të fundit as nuk identifikohen dhe as janë të identifikueshëm. Tabelat informuese për CCTV-të ishin të vendosura në hyrje të zyrave".

Pavarësisht qëndrimit të përfaqësuesit të kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se të dhënat e përpunuara nga kontrolluesi janë të dhëna personale sipas parashikimit të pikës 1 të nenit 3, të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, i cili cilëson si të dhënë personale çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Pika 12 e po këtij neni parashikon se "*Përpunim i të dhënave personale*" është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit vlerëson se të dhënat e përpunuara (numër celulari klienti, numër targe automjeti, numër kontrate, numër personal karte identiteti) mund ta bëjnë lehtësisht të identifikueshëm subjektin e të dhënave nëpërmjet përdorimit të këtyre faktorëve të veçantë të identitetit të tij.

Referuar pretendimeve dhe dokumenteve të paraqitura si provë nga kontrolluesi, Zyra e Komisionerit vlerëson se dërgimi i sms-ve të marketingut nga kontrolluesi (siç parashtrohet në pikën 4 të konstatimeve më sipër) pa pëlqimin e subjekteve të të dhënave, drejt subjekteve të dhënat e të cilëve janë mbledhur për qëllim tjetër (pagesa për faturat për telefoninë celulare), pavarësisht kohëzgjatjes së këtij veprimi, nuk është në përputhje me frymën e ligjit, pasi nuk garanton zbatimin e nenit 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008

“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, duke mos legjitimuar përpunimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

Në nenin 3 pika 24 e ligjit, përcaktohet kuptimi i “pëlqimit” të subjekteve të të dhënave sipas të cilit: *“Pëlqim i subjekteve të të dhënave është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij”*.

Për sa kohë kontrolluesi nuk ka mundur të provojë ekzistencën e pëlqimit të subjekteve të të dhënave për përpunimin e të dhënave të tyre me qëllim marketingu, vlerësojmë se përpunimi i të dhënave është i paligjshëm, duke cënuar edhe parimin e sanksionuar në nenin 5/1/a të ligjit.

Lidhur me konstatimin e grupit të hetimit siç pasqyrohet në pikën 5 më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, bëhet me autorizim të komisionerit kur parashtrohen siguri të mjaftueshme në lidhje me mbrojtjen e privatësisë dhe të të drejtave e lirive themelore të njeriut, si dhe në lidhje me ushtrimin e së drejtës përkatëse. Për sa kohë kontrolluesi nuk ka kërkuar autorizimin e Komisionerit për transferimin e të dhënave në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, vlerësojmë se transferimi është i paligjshëm referuar nenit 9 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Sa i përket konstatimit në pikën 6 më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se mospublikimi i *“politikave të privatësisë”* në faqen e internetit, privon subjektet e të dhënave personale nga e drejta për informim dhe të drejtat e parashikuara në kreun IV “Të drejtat e subjektit të të dhënave”, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, duke mos u dhënë mundësi në ushtrimin e tyre dhe duke i cënuar ato.

Në lidhje me pretendimin e përfaqësuesit të kontrolluesit lidhur me konstatimin në pikën 7 më sipër se tabelat informuese për CCTV-të ishin të vendosura në hyrje të zyrave të shoqërisë “Pay and Go” Shpk, Zyra e Komisionerit vlerëson se ato nuk janë sipas formatit standard të miratuar nëpërmjet Udhëzimit nr. 3, datë 05/03/2010 *“Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”*, i ndryshuar. Në këtë kuadër vlerësojmë se nuk është respektuar neni 18 i ligjit pasi subjektet e të dhënave nuk janë informuar mbi mundësinë e ushtrimit të të drejtave të tyre të sanksionuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe mbi mundësinë për të kontaktuar me kontrolluesin nëpërmjet numrit të telefonit.

Lidhur me pikën 8 të konstatimeve më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte

të drejtat që i jep ligji. Në paragrafin 1, të nenit 21 të ligjit, parashikohet: “Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.

Siç është parashtruar në mënyrë paraprake dhe në pikën 9 të konstatimeve më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i rregullores sipas proceseve të përpunimit është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave për çdo punonjës dhe përcakton standardet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektsh të të dhënave.

Lidhur me konstatimin e pasqyruar në pikën 10 më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i kontrolluesit mbi transferimin e të dhënave është mjaft i rëndësishëm pasi kontrolluesi është përgjegjës për kontrollin e nivelit të sigurisë së të dhënave personale që përpunohen/transferohen për llogari të tij nga përpunuesi. Të drejtat e subjekteve të të dhënave duhet të garantohen në çdo rast dhe në të njëjtin nivel si nga kontrolluesi dhe nga përpunuesi. Garantimi i të drejtave të subjekteve garanton përpunimin e ligjshëm, të saktë dhe të drejtë të të dhënave personale. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e përpunuesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton sigurinë e të dhënave personale dhe ndalon mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

Sa më sipër, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronjat “a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh”, e Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10.000 deri në 500.000 lekë;*
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*
- c) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;*

Kontrolluesi “Pay and Go” Shpk, në formën ligjore të aktivitetit të tij tregtar është person juridik dhe sipas nenit 39/2 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, dënohet me dyfishin e gjobave të përcaktuara më sipër.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit mban parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me garantimin e përpunimit të ligjshëm të të dhënave, informimin e subjekteve të të dhënave mbi qëllimin e përpunimit dhe mostejkalimin e këtij qëllimi, garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale dhe sigurinë e të dhënave personale që përpunohen/transferohen si dhe reagimin e kontrolluesit ndaj konstatimeve të pasqyruara në procesverbalin e hetimit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6/1/a, 9, 18, 21, 27, 29, 30, 31, 39/1/a, 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Pay and Go" Shpk me gjobë, në vlerën 40 000 (dyzetë mijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "Pay and Go" Shpk me gjobë, në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 9 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Dënimin e kontrolluesit "Pay and Go" Shpk me gjobë, në vlerën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
4. Urdhërimin e kontrolluesit "Pay and Go" Shpk për bllokimin e aksesit *remote*, që i është dhënë shoqërisë "MPS" LLC me seli në Federatën Ruse, në bazën e të dhënave në serverat qendrorë të tij, dhe paraqitjen e kërkesës për autorizim nga Komisioneri për transferimin e të dhënave në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, në zbatim të nenit 9 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe Vendimit të Komisionerit Nr. 8, dt. 31.10.2016 "Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale". Ky urdhër bllokimi do të mbetet në fuqi deri në momentin e dhënies së autorizimit për transferimin ndërkombëtar të të dhënave drejt Federatës Ruse, si vend me nivel të pamjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave.
5. Kontrolluesi "Pay and Go" Shpk, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje përmbushjen në vazhdim të detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë.

6. "Pay and Go" Shpk, në cilësinë e përpunuesit, të ketë në vëmendje krijimin e kushteve të nevojshme teknike dhe organizative, në marrëveshje me kontrolluesit, për përmbushjen e detyrimeve në zbatim të nenit 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.
7. Kontrolluesi "Pay and Go" Shpk, në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
8. Kontrolluesi "Pay and Go" Shpk, në përmbushje të detyrimeve të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të hartojë një rregullore gjithëpërfshirëse "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale".
9. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikat 4, 5, 6, 7 dhe 8 të këtij Vendimi, brenda një afati 45 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
10. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbartimit.
11. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 22.11 2017

